



RAPORT MONITORIMI JANAR – MARS 2019

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

I. Përmbledhje ekzekutive mbi monitorimin e Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2017-2020 dhe Planit të Veprimit për periudhën Janar – Mars 2019.....	4
a. Përmbledhje ekzekutive mbi reformën e sistemit të drejtësisë	6
II. Metodologjia e monitorimit	12
III. Disbursimi financiar	14
IV. Progresi i zbatimit sipas objektivave	15
Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.....	15
Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.	17
Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.	18
Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.....	19
Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.	20
Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.....	21
Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.....	22
Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.	23
V. Arritjet kryesore gjatë periudhës Janar – Mars 2019.....	24
VI. Nevoja për rishikim të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë.....	27
VII. Konkluzione	27
IX.Sfidat.....	28
Aneks 1 – Progresi lidhur me paketën e 27 ligjeve të reformës në drejtësi	29
Aneks 2 – Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë.....	31

LISTA E SHKURTIMEVE

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ALBIS	Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbaramit Gjyqësor
AP	Avokati i Popullit
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaramit
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
DHKPGJP	Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLGG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
QPZ	Qendra e Publikimeve Zyrtare
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2020
SPAK	Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHP	Shërbimi i Provës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2017-2020 DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERIUDHËN JANAR - MARS 2019.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2020 dhe Planit i saj i Veprimit është miratuar nga Këshilli i Ministrave, me Vendimin 773, datë 02/11/2016.

Misioni i kësaj strategjie është zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane.

Strategjia ka *tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë*, të cilat janë:


1. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
2. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
3. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
4. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
5. Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
6. Shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor.
7. Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse.
8. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017 - 2020 dhe përbën raportin e parë të monitorimit për vitin 2019. Raporti mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar 2019 deri më 31 mars 2019. Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SND-së.


Plani i Veprimit përbëhet nga 8 objektivat e mësipërme dhe përmban në total 201 nën-aktivitete¹. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të nën-aktiviteteve, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektiv. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të nën-aktiviteteve të SND-s bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit prill 2019. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar - mars 2019, rezulton se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë:

¹ Nën-aktiviteti 3.01.c “Regjistrimi i Domain” me institucion përgjegjës Kuvendin, të parashikuar në PV të SND-së, nuk është përfshirë në numërim/analizë pasi ky nën-aktivitet nuk i përgjigjet nevojave të institucionit dhe për këtë arsye duhet të rishikohet “institucioni përgjegjës”.

Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave



Progresi total i nën-aktiviteteve të Strategjisë



Për periudhën janar – mars 2019 nga 201² nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 66 prej tyre, 53 janë ende në proces zbatimi, 80 nën-aktivitete të porealizuara, si dhe 2 nën-aktivitete të paraportuara nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit është në nivelin 33% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 26% për nën-aktivitetet në proces, 40% për nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse dhe 1% nën-aktivitetet të paraportuara.

² Nga totali prej 201 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit, 65 prej tyre janë nën fushën e përgjegjësisë së institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI REFORMËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

o Progresi në Legjislacion

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar së fundmi një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standarteve evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Shqipëria filloi zbatimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj. *Për më tepër, një paketë prej 27 ligjesh është planifikuar të miratohet, duke mbuluar të gjitha aspektet e reformës gjyqësore, ku deri më tani Kuvendi ka miratuar 22 prej tyre, si dhe një vendim, duke e përmbyllur kështu paketën e reformës së drejtësisë³.*

Në muajin dhjetor 2018, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 110/2018 "*Për Noterinë*"⁴. Ligji përcakton rregullat për ushtrimin e profesionit të noterit, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të noterisë në Republikën e Shqipërisë. Për më tepër, ligji përcakton dhe procedurat për provimin e pranimit në formimin fillestar, krijimin e pozicionit të zëvendësnoterit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së zëvendësnoterëve, mbikqyrjen dhe përgjegjësinë disiplinore, kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat, financimin e veprimtarisë noteriale, organizimin dhe funksionimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë etj.

Në muajin prill 2019, Kuvendi miratoi Vendimin Nr. 47/2019, datë 18.04.2019 "*Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 – 2023*". Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) përcakton vizionin, objektivat strategjike dhe specifike të edukimit ligjor të publikut (ELP) përgjatë periudhës 2019-2023. SELP është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Vizioni i ELP për vitet e ardhshme është: *Qytetarë më të ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.*

Në muajin prill 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 25/2019 "*Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore*". Ky ligj përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me: a) organizimin dhe funksionimin e shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore; b) veprimtarinë e tyre hetimore; c) statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore; ç) raportet me prokurorinë dhe me institucionet shtetërore ku bëjnë pjesë.

Në muajin maj 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 26/2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat"*.

³ Më tepër informacion mbi paketën e 27 ligjeve është pasqyruar në aneksin 1 të këtij raporti.

⁴ Botuar në Fletoren zyrtare Nr. 16, dt. 13 shkurt 2019. Më datë 07.02.2019, me Vendimin Nr. 29/2019 është rrëzuar Dekreti Nr. 11 054, Datë 14.1.2019, të Presidentit të Republikës, "Për Kthimin e ligjit Nr. 110/2018 'Për Noterinë'".

○ Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet ekzistuese janë modifikuar dhe institucione të reja janë krijuar nga amendamentet kushtetuese dhe ligjet specifike organike të lartpërmendura.

Ministria e Drejtësisë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” nuk ushtron më kompetencën e kontrollit të veprimtarisë së prokurorive dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe të dhënies së rekomandimeve për procedim disiplinor në rastin e prokurorëve dhe procedimin disiplinor në rastin e gjyqtarëve. Nga hyrja në fuqi e këtij ligji (22.11.2016), çdo ankesë apo informacion, që nga verifikimi paraprak kur rezulton se ka indicie të besueshme për shkelje disiplinore nga ana e magjistratit, i përcillet për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme të procedurave ILD-së.

Institucionet e krijuara rishtazi dhe ato që parashikohen të ngrihen janë si në vijim:

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016⁵.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016⁶.
- Njësia e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016.
- Gjykata kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – Kushtetuta dhe Ligji nr. 98/2016.
- Këshillat e Gjykatave – Ligji nr. 98/2016⁷.
- Institucionet Ri-vlerësuese – Ligji nr. 84/2016⁸.

Përsa i përket institucioneve të krijuara rishtazi, **një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi shënoi ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilat janë 2 shtyllat për një sistem gjyqësor të pavarur dhe cilësor.**

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe parashikimet e nenit 277, pika 3, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me besimin dhe angazhimin e plotë se do të sigurojë një sistem gjyqësor të drejtë, i cili mbështetet në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të eficiencës, në mbledhjen e datës 20.12.2018, me vendimin nr. 4 u krijua Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Që nga krijimi i KLGJ dhe deri më 03.05.2019, janë marrë 70 vendime, të cilat kanë pasur në fokus:

- i. rregullimin e veprimtarisë së KLGJ-së;
- ii. mirë administrimin e gjykatave nëpërmjet rregulloreve të ndryshme si, skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin në çështje të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave.

⁵ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_115_2016_per_organet_e_qeverisjes_se_sistemit_te_drejtisesise_1726.pdf

⁶ <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/10/ligj-nr-95-dt-6-10-2016.pdf>

⁷ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/209-2016.pdf

⁸ <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/VETINGU/ligj-nr-84-dt-30-8-2016.pdf>

- iii. statusin e gjyqtarëve duke përfshirë nisjen e procesit të emërimit të magistratëve të rinj, ***nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar***, mbarimin e statusit të magistratit për shkak të daljeve në pension, përfundimit të mandatit, dorëheqjeve, etj.

Pas zgjedhjes së organeve drejtuese, të kryetarit dhe të zëvendëskryetarit, si dhe të anëtarëve të cilat do të ushtrojnë detyrën me mandat 3-vjeçar, KLGJ ka miratuar rreth 7 vendime, të karakterit rregullator, si dhe 7 vendime të cilat kanë të bëjnë me ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme dhe të komisioneve të përkohshme.

Duke marrë në konsideratë problematikat e shfaqura, KLGJ ndërmoi hapat e nevojshme për adresimin dhe zgjidhjen e tyre, konkretisht në lidhje me:

- ✚ Vakumin në sistemin e drejtimit në gjykata si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të gjykatave gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar;
- ✚ Caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kur ligji parashikonte një afat dyjavor nga krijimi i KLGJ-së;
- ✚ Nisje e procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magistratëve të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës (SHM) në vitin 2018 dhe pranimet e reja në SHM;
- ✚ Ngritja e strukturës përkatëse për vijimin e bashkëpunimit me institucionet e rivlerësimit kalimtar;
- ✚ Verifikimi i kriterëve ligjorë për kancelarët në detyrë;
- ✚ Ngritja e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta;
- ✚ Vlerësimi i situatës dhe ngritja e komisionit për shqyrtimin e ankesave të subjekteve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- ✚ Trajtimi i një volumi të madh me kërkesa të ardhura nga gjykatat ku kërkohej delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara;
- ✚ Ngritja e komisioneve dhe strukturës administrative në shërbim të KLGJ.

Për të bërë të mundur përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësisë që Kushtetuta dhe kuadri ligjor ngarkon Këshillit të Lartë Gjyqësor, me vendimin Nr.44, datë 12.03.2019, Këshilli miratoi strukturën organizative të administratës së tij. Kjo strukturë është miratuar dhe nga Kuvendi.

Përsa i përket progresit të **Këshillit të Lartë të Prokurorisë**, reforma gjyqësore synon, ndër të tjera, forcimin dhe garantimin e pavarësisë së KLP. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sikurse parashikohet në nenin 149 të Kushtetutës, garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Përkatësisht, më datë 11 dhjetor 2018, u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në fund të procesit të votimit u përzgjedhën 6 prokurorë, si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbajti takimin e parë më datë 19 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i themeluar tashmë, është autoriteti kompetent për emërimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në bazë të nenit 179/8 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit “Për statusin e organizimit dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (këtej e tutje Ligji për SPAK) dhe të nenit 48/2 dhe 3 të ligjit “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë njoftoi më 7 janar 2019 fillimin e procedurave për plotësimin e 15 pozicioneve vakante në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në fund të afatit, më 21 shkurt 2019, **28 kandidatë kanë aplikuar, ku vetëm 25 prej tyre plotësojnë kushtet ligjore për të vazhduar garën për prokurorë të posaçëm.** Aktualisht, nga 25 prokurorë në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, vetëm 5 prej tyre janë konfirmuar me vendim të formës së prerë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Meqenëse një prej këtyre 25 kandidatëve u zgjodh nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve e mbajtur në muajin Prill 2019 si anëtar i KLP-së, aktualisht ka vetëm 24 kandidatë për SPAK. Aplikuesit do t'i nënshtrohen procesit të vettingut nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve dhe ata që vlerësohen pozitivisht nga Komisioni do të dorëzohen në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili do të zgjedhë dhe emërojë prokurorët në SPAK.

Nga konstituimi i saj në dhjetor 2018, KLP është fokusuar në disa aktivitete si më poshtë:

- Rregullorja për Veprimtaritë Jashtë Funksionit të Prokurorëve u miratua në muajin shkurt 2019. Ky akt përcakton rregulla të detajuara që lidhen me aktivitetin e prokurorit të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to (veprimtari jashtë funksionit) gjatë dhe jashtë orarit të punës dhe procedurën e pajisjes me autorizim nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Miratohet Rregullorja për Organizimin e Shortit për Përzgjedhjen e Dosjeve në kuadër të Procesit të Ri-vlerësimit;
- Përcaktimi i numrit të magjistratëve kandidatë për pranimin në trajnimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin e ardhshëm akademik, si dhe në muajin prill 2019 u organizua provimi hyrës;
- Në janar ka filluar procedura për emërimin e magjistratëve kandidatë të diplomuar në vitin 2018. Kërkesat individuale të prokurorëve janë duke u përfshirë dhe diskutuar në seancën plenare të Këshillit.

Në mbledhjen plenare të datës 19 mars 2019, KLP vendosi:

- Miratimin e rregullores “Mbi ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.
- Miratimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë";
- Fillimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm.

Përsa i përket krijimit të **Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë (KED)**, në zbatim të nenit 149/d të Kushtetutës, kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, midis radhëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ata ushtrojnë mandatin e tyre për një vit. Më datë **7 dhjetor 2018**, Kryetari i Kuvendit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d të Kushtetutës,

nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Urdhrit nr. 2, datë 3.12.2018, të Kryetarit të Kuvendit “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm). Në përfundim të hedhjes së shortit, u emëruan 8 anëtarë të Këshillit të Emërimit të Drejtësisë, si dhe tre anëtarë zëvendësues. Një nga anëtarët e KED, konkretisht Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, u shkarkua nga detyra me një vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Rrjedhimisht, KED për vitin 2019 ka vetëm 7 anëtarë dhe tre anëtarë zëvendësues. **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, i emëruar sipas këtij shorti, ushtron funksionin e tij për një vit kalendarik duke filluar nga **data 1 janar 2019**.

Deri më datën **10 prill 2019**, KED ka organizuar 15 mbledhje, në të cilat ka miratuar Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e KED-së; vendimin mbi Procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion; miratimin e Aktit Normativ mbi përcaktimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë; miratimin e Akteve Normative mbi vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, diskutimin në parim mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese etj.

o Procesi i vlerësimit dhe ecuria e institucioneve ri-vlerësuese

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organ i ri kushtetues, me mandat 5-vjeçar, i krijuar me ndryshimet e reja të Kushtetutës, si pjesë e paketës për Reformën në Drejtësi, për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, miratoi në bllok listën me 12 komisionerë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i ligjit është rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve të rivlerësimit) në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni vlerëson çështjet e subjekteve të rivlerësimit në 4 trupa gjyqësore me 3 anëtarë secila, bazuar në tre kritere:

- a) Vlerësimi i pasurisë;
- b) Vlerësimi i figurës;
- c) Vlerësimi i aftësive profesionale.

Gjatë muajit **Janar 2019**, Komisioni dha 3 vendime për shkarkimin nga detyra dhe 4 vendime për konfirmimin në detyrë të subjekteve të rivlerësimit.

Gjatë muajit **Shkurt 2019**, Komisioni dha 5 vendime për shkarkimin nga detyra, 3 vendime për konfirmimin në detyrë dhe 1 vendim për ndërprerje të procesit të subjekteve të rivlerësimit.

Gjatë muajit **Mars 2019**, Komisioni ka dhënë 5 vendime për shkarkimin nga detyra, 2 vendime për konfirmimin në detyrë dhe 13 vendime për përfundimin e procesit të subjekteve të rivlerësimit.

Në total për periudhën janar – mars 2019 Komisioni ka dhënë **36 vendime**, nga të cilat:

- a) 9 vendime për konfirmimin në detyrë të 2 gjyqtarëve, 4 prokurorëve dhe 3 ndihmësve ligjorë;
- b) 13 vendime për shkarkimin nga detyra të 7 gjyqtarëve, 5 prokurorëve dhe 1 këshilltari ligjor;
- c) 1 vendim për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të 1 gjyqtari;
- d) 13 vendime për përfundimin e procesit të rivlerësimit të kryeinspektorit të ILD-së, 9 gjyqtarëve dhe 3 prokurorëve.

Kolegji i Posaçëm i Apelit vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelit është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Për periudhën janar – 31 mars 2019, pranë KPA-së janë regjistruar **15** çështje të reja, ndërsa gjithsej, të regjistruara pranë KPA-së janë **55** çështje. Duke patur parasysh edhe çështjet e regjistruara në Kolegj në vitin 2018, për të cilat nuk ka përfunduar gjykimi, në total, çështje duke u shqyrtuar janë **37 (tridhjetë e shtatë)**.

Nga 37 çështje që janë duke u shqyrtuar, **7 (shtatë)** janë nën gjykim (seancat janë planifikuar të zhvillohen në datat: 3, 16 dhe 18 prill (për proceset që zhvillohen në dhomë këshillimi) dhe në datat 4, 12, 17 dhe 18 prill (për proceset që zhvillohen në seancë publike), ndërsa **30** çështje (tridhjetë) janë në përgatitje për gjykim.

Deri në datën 31.03.2019 Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur **18 vendime** (nga të cilat 12 vendime i përkasin viti 2018 dhe 6 vendime periudhës janar - 31 mars 2019) të Juridiksionit të Rivlerësimit.

Nga 18 çështjet të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:

- I. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – **në 13 vendime**;
- II. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me përmbajtjen në dispozitiv për, ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - **në 2 vendime**;
- III. Pushimin e shqyrtimit të çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga ankuesi – **në 1 vendim**.
- IV. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit – **në 2 vendime**.

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve është parashikuar në nenin 53 të ligjit nr.84/2016, sipas të cilit çdo person që është në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejtë institucionet e rivlerësimit. Në këtë kuadër, deri më 31 mars 2019, në regjistrin e denoncimeve të publikut të KPA-së, janë regjistruar gjithsej **195** denoncime. Denoncuesit kanë marrë përgjigje zyrtare lidhur me ankimet e përcjella pranë Kolegjit.

Institucioni i **Komisionerëve Publikë** si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca:

- a. Ankimon në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 15 ditë pas njoftimit (neni 63 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Përgatit raportin me shkrim me arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (aneksi kushtetues, neni B “Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Institucioni i Komisionerëve Publikë, për periudhën janar - mars 2019, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për **36 vendime**. 3 prej tyre janë ankimuar dhe për 21 vendime është vendosur mosankim. Në proces shqyrtimi ishin 12 vendime të KPK-së.

Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën janar - mars 2019, janë regjistruar **66 denoncime**.

Aktet nënljore dhe normative të miratuara nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë.

- Rregullorja “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë”;
- Rregullore e brendshme administrative e Institucionit të Komisionerëve Publikë;
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë;
- Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Institucionin e Komisionerëve Publikë”;
- Rregullore për median.

Ministria e Drejtësisë ka lehtësuar procesin e rivlerësimit në tre drejtime kryesore:

- Duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për organet e rivlerësimit;
- Duke siguruar mjetet financiare për organet e rivlerësimit;
- Duke bashkëpunuar me organet e vetingut mbi kërkesat për informacion të paraqitura në kuadër të procesit të rivlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit që po kryhen nga këto organe.

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë,” pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga 1 janar deri në 31 mars 2019 dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të SND-së. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo politike dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të nën-aktiviteteve, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektiv. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht online, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura.

Gjatë muajit mars 2019, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin EURALIUS ka hartuar Rregulloren e Brendshme të Komitetit të Monitorimit të SND, si dhe Rregulloren e Brendshme për Grupin e Punës të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për Koordinimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, e cila në vijim është dakortësuar dhe miratuar nga Komiteti Monitorues. Në rregullore specifikohet se përgjegjësitë institucionale për monitorimin e zbatimit të SND-së koordinohen nga një **Grup Pune** për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (GP). Gjithashtu, në rregullore propozohet që të mbahet dhe të zgjerohet ky grup pune në mënyrë që të përfshijë përfaqësues nga të gjitha institucionet e përfaqësuara në Komitetin e Monitorimit dhe të ngarkohen me përgjegjësi për monitorimin e nivelit operativ. Ky GP do të përbëhet nga “zbatues aktivë” të institucioneve dhe duhet të jetë përgjegjës për mbledhjen e informacionit lidhur me ecurinë e Planit të Veprimit. Ai duhet të mbledhet **të paktën çdo tre muaj**.

Janë propozuar dy raporte për përpunim të mëtejshëm:

- I. Raportet e progresit të Planit të Veprimit do të paraqiten një herë në gjashtë muaj dhe vjetore;
- II. Monitorimi i raporteve të progresit kundrejt objektivave të Pasaportës së indikatorëve do të realizohet një herë në vit.

Përsa më sipër, pas hartimit të draft-raporteve përmbledhëse *mbi baza tremujore dhe nëntëmujore*, Ministria e Drejtësisë dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, në mbështetje të procesit të monitorimit. Në përfundim të procesit konsultues, MD kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para organizimit të takimeve mbi baza tremujore me **Grupin e Punës** për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë.


Përsa i përket *hartimit të draft raporteve gjashtëmujore dhe vjetore*, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para se të miratohet nga Mekanizmi Institucional i Monitorimit. Pas miratimit të Raporteve Gjashtëmujore dhe Vjetore të Monitorimit, Raporti përfundimtar publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

III. DISBURSIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2017 - 2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë është vlerësuar në 98,385,653 Euro. Në momentin e hartimit të planit të veprimit hendeku financiar është vlerësuar të jetë në masën 35% të totalit. Meqenëse hendeku financiar apo edhe kosto e përgjithshme e PV 2017-2021 nuk është rishikuar që prej aprovimit të Strategjisë, statistikatat financiare të raportuara në vijim i referohen kostove të parashikuara në momentin e miratimit të planit të veprimit.

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2017-2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë shpërndahen si më poshtë mbi llojet e shpenzimeve dhe viteve:

Kategoria	2017	2018	2019	2020	2021	Totali	% e totalit të përgjithshëm
Kapitale	6.666.978	14.425.000	9.836.000	5.240.000	3.619.922	39.787.900	40,44%
Pagat	5.286.060	5.346.060	12.066.260	12.106.260	12.106.260	46.910.900	47,68%
Trajnime	885.000	260.000	310.000	222.000	195.000	1.872.000	1,90%
Shpenz. tjera aktuale	1.919.713	707.285	2.172.285	2.590.285	2.425.285	9.814.853	9,98%
Totali i Përgjithshëm	14,757,751	20,738,345	24,384,545	20,158,545	18,346,467	98,385,653	100.00%



Për të eliminuar efektin financiar (hendekun financiar), është krijuar një fond rezervë për vitet 2017-2020.

Shuma	në Euro
Kostot totale për zbatimin e Strategjisë	98,385,653
Hendeku financiar para fondit rezervë	92,285,653
Hendeku financiar pas Fondit Rezervë	34,822,967, specifikisht 35% të kostove totale



Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi masën e disbursimit financiar në bazë aktiviteti të kryer. Nga analiza për aktivitetet e raportuara rezulton se për periudhën janar – mars 2019 janë shpenzuar në total rreth **505,253,376 Lekë**⁹.

IV. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe pasqyron grafikiisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën janar – mars 2019¹⁰.

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.


Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 1

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 1	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 1
Të realizuara	10	24%
Në proces	7	17%
Të porealizuara	23	55%
Të paraportuara	2	4%
Totali	42	100%

⁹ Buxheti i cili është i njëjtë për disa nga nën-aktivitetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për një pjesë të nën-aktiviteteve të Shkollës së Magjistraturës është përlogaritur vetëm një herë në koston totale të SND-së, pasi është i njëjti zë, i cili përsëritet në disa nën-aktivitete.

¹⁰ Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është pasqyruar në aneksin 2 të Raportit të Monitorimit.

Statusi i nën-aktiviteteve të Objektivit 1



PËRQINDJAE STATUSIT TË NËN-AKTIVITETEVE




Rezulton se nga 42 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 1 janë realizuar 10 prej tyre, 7 janë ende në proces zbatimi, 23 nën-aktivitete të porealizuara dhe 2 nën-aktivitete të paraportuara nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 24% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 17% nën-aktivitetet në proces, 55% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse, si dhe 4% nën-aktivitetet të paraportuara.

Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 2

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 2	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2
Të realizuara	8	62%
Në proces	1	8%
Të parealizuara	4	30%
Totali	13	100 %




Rezulton se nga 13 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 2 janë realizuar 8 prej tyre, 1 është ende në proces zbatimi dhe 4 nën-aktivitete janë të parealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektivi është në nivelin 62% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 8% nën-aktivitetet në proces, 30% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 3

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 3	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 3
Të realizuara	9	70%
Në proces	2	15%
Të parealizuara	2	15%
Totali	13	100 %




Rezulton se nga 13 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 3 janë realizuar 9 prej tyre, 2 janë ende në proces zbatimi dhe 2 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektivi është në nivelin 70% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 15% nën-aktivitetet në proces dhe 15% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 4

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 4	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 4
Të realizuara	15	65%
Në proces	2	9%
Të porealizuara	6	26%
Totali	23	100 %




Rezulton se nga 23 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 4 janë realizuar 15 prej tyre, 2 janë ende në proces zbatimi dhe 6 nën-aktivitete të porealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 65% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 9% nën-aktivitetet në proces dhe 26% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 5

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 5	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 5
Të realizuara	4	14%
Në proces	7	23%
Të porealizuara	19	63%
Totali	30	100 %




Rezulton se nga 30 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 5 janë realizuar 4 prej tyre, 7 janë ende në proces zbatimi dhe 19 nën-aktivitete të porealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 14% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 23% nën-aktivitetet në proces dhe 63% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 6

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 6	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 6
Të realizuara	8	47%
Në proces	4	24%
Të parealizuara	5	29%
Totali	17	100%




Rezulton se nga 17 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 6 janë realizuar 8 prej tyre, 4 janë ende në proces zbatimi dhe 5 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 47% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 24% nën-aktivitetet në proces dhe 29% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 7

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 7	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 7
Të realizuara	8	20%
Në proces	21	51%
Të parealizuara	12	29%
Totali	41	100 %




Rezulton se nga 41 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 7 janë realizuar 8 prej tyre, 21 janë ende në proces zbatimi dhe 12 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 20% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 51% nën-aktivitetet në proces dhe 29% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 8

Janar – Mars 2019		
Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 8	Numri i nën-aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 8
Të realizuara	4	18%
Në proces	9	41%
Të porealizuara	9	41%
Totali	22	100 %



Rezulton se nga 22 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 8 janë realizuar 4 prej tyre, 9 janë ende në proces zbatimi dhe 9 nën-aktivitete të porealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektivi është në nivelin 18% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 41% nën-aktivitetet në proces dhe 41% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

V. ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2019.

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën tremujore, në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë si më poshtë vijon:

- Një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi shënoi ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë muajit dhjetor 2018, të cilat janë dy shtyllat për një sistem gjyqësor të pavarur dhe cilësor. Për më tepër, nga periudha e krijimit deri në muajin mars 2019, KLGJ dhe KLP kanë marrë një sërë iniciativash dhe në këtë kuadër janë miratuar rregullore të ndryshme sipas fushës së përgjegjësisë së secilit institucion.
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar punën zyrtarisht në datë 15.01.2019 dhe për periudhën 3 mujore, ka realizuar një punë voluminoze, delikate dhe produktive, duke miratuar të gjithë aktet dhe rregulloret e nevojshme për inicimin e procesit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe Rregulloren e Brendshme “Për Funkcionimin e KED”.
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në faqen e Gjykatës së Lartë, ka rubrikën e vet, ku është baza e të dhënave të nevojshme dhe e aksesueshme për të gjithë personat e interesuar. Në këtë faqe janë pasqyruar të gjitha mbledhjet e zhvilluar nga ana e këshillit, aktet e miratuara prej tij, listat me emërat përkatës të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për një nga pozicionet në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, dokumentacioni i nevojshëm që duhet plotësuar dhe dorëzuar nga të gjithë kandidatët, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm me qëllim bërjen publike dhe transparente të të gjithë procesit.
- Referuar ligjit 96/2016, kanë ndryshuar pagat e magistratëve për vitin 2019. Zbatimi i sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera për magistratët kanë hyrë në fuqi në datën 1 janar 2019, sipas parashikimeve të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Përsa i përket trajnimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për periudhën tremujore, Shkolla e Magjistraturës ka realizuar në total **77** trajnime, në të cilat kanë marrë pjesë gjithsej 875 pjesëmarrës¹¹: 413 gjyqtarë, 188 prokurorë dhe 274 të tjerë (magjistratë të diplomuar, kandidatë për magjistratë, këshilltarë e ndihmës ligjorë, avokatë shteti, oficerë të policisë gjyqësore, avokatë, specialistë, lektorë).
 - Tematikat e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës në sesionet trajnuese janë nga fushat penale, civile, administrative si më poshtë: administrimi i gjykatave, falimentimi, të drejtat e njeriut, e drejta e BE-së, drejtësia penale për të mitur, pronësia, krimi mjedisor, trajnim trajnerësh, procedura civile dhe penale, trafikimi i qënieve njerëzore, dhuna në familje, pronësia intelektuale, etika profesionale, terrorizmi, shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar etj.

¹¹ Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magistrati në të paktën një sesion trajnues.

- Është ndërtuar sistemi i integruar për publikimin e ligjeve të konsoliduara dhe akteve nënligjore të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave (Arkiva Elektronike e QBZ), e cila ka përfunduar në datë 29.03.2019. Projekti ka arritur objektivin e përgjithshëm: krijimin e Sistemit të Arkivës Elektronike të Akteve, që shërben për rregjistrimin, editimin, publikimin, përditësimin, ruajtjen, administrimin dhe aksesimin e të gjithë akteve të botueshme në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, politikat kombëtare dhe praktikave më të mira në botë në këtë drejtim.
 - Me dorëzimin e sistemit, si pjesë integrale e sistemit, ka përfunduar popullimi i akteve ekzistuese për periudhën 2000 – 2018.
- Në muajin Janar 2019, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor në bashkëpunim me AKSHI-n, bëri të mundur publikimin e faqes zyrtare të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor: www.ashsgj.gov.al.
- Me mbështetjen e misionit EURALIUS V dhe USAID, si dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, janë kryer një numër trajnimesh me anëtarët e KLGJ mbi planifikimin strategjik, menaxhimin e sistemit gjyqësor, etj.
- Përsa i përket krijimit të një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës juridike falas për individët dhe grupet në nevojë, bashkëpunimi mes KLGJ dhe Ministrisë së Drejtësisë ka nisur në përmbushje të këtij objekti dhe konkretisht me përcaktimin e qendrave të para për ofrimin e ndihmës juridike falas në rrethet Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Durrës, pranë ambienteve të gjykatave respektive të shkallës së parë të rretheve.
- Për periudhën janar – mars 2019 është organizuar trajnimi 3 mujor online mbi “Drejtësinë Miqësore për të Miturit dhe të Drejtat e Fëmijëve” e organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës.
- Ministria e Drejtësisë është në ndjekje të vazhdueshme të procesit të Konsultimit Publik. Nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit janë publikuar në faqen www.konsultimipublik.gov.al të gjitha aktet objekt të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Aktualisht për periudhën tremujore janë publikuar 5 projektligjet e paketës penitenciare.
- Përsa i përket rritjes së mundësisë për punësimin e të burgosurve dhe ofrimin e programeve të edukimit/programeve të aftësive jetësore sipas standardeve evropiane të praktikave më të mira, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Si rezultat, për periudhën Janar-Mars 2019, kurset profesionale janë ofruar në 10 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga **454** të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj, pikturë, pirografi, elektrikist, turizëm, rrobaqepësi etj.
 - Janë hartuar dhe vënë në zbatim programe edukuese për të burgosurit në prag lirim. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste.

- Rehabilitimi i personave të burgosur, ish përdorues të lëndëve narkotike është një objektiv i veçantë i sektorit të edukimit. Në këtë kuadër ofrohen programe për personat e burgosur të cilët kanë qenë përdorues të lëndëve narkotike në jetën e lirë. Këto programe janë frekuentuar mesatarisht në muaj nga 107 të burgosur.
- Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën gjatë 1 muaji aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve është 2860. Gjatë janar - mars 2019 në IEVP janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 140 tema sociale në muaj dhe 26 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 419 aktivitete ri-integruese.
- Janë hartuar dhe miratuar programet e trajnimit për stafin e ri civil. Programet janë pasuruar me module praktike për menaxhimin e personave me liri të kufizuar dhe drejtimin human të burgjeve. Për periudhën raportuese janë trajnuar afërsisht 40 staf civil multidisiplinar.
- Gjatë periudhës tremujore janë nënshkruar 8 marrëveshje bashkëpunimi me OJQ, ku qëllim kryesor i bashkëpunimit mbetet përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave me liri të kufizuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.
- Për periudhën raportuese është realizuar nga investimet e parashikuara furnizim dhe vendosje të pajisjeve fundore të vëzhgimit me kamera, sistem radiosh në IEVP Jordan Misja Tiranë.

VI. NEVOJA PËR RISHIKIM TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË NDRËSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Institucionet kanë raportuar nevojën për rishikimin e Planit të Veprimit të SND-së, në mënyrë që aktivitetet e saj të konvertohen në përfitime konkrete, për targetin të cilit i drejtohen, si dhe të fokusohen në çështjet më të domosdoshme për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.

Kjo nevojë për rishikim lidhet kryesisht me faktorë si:

- ❖ moskrijimi në kohë i institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë si Inspektori i Lartë i Drejtësisë, SPAK, si dhe Byroja Kombëtare e Hetimit.
- ❖ rishikimin e aktiviteteve dhe/apo treguesve të saj të zbatimit në mënyrë që të sigurohet një përputhshmëri më e mirë me realizimin e qëllimit;
- ❖ ndryshimin e përgjegjësisë institucionale për zbatim dhe/apo institucioneve bashkëpunuese, pasi jo në pak raste vihet re që ka problematikë në përcaktimin e institucionit përgjegjës për realizimin e një aktiviteti;
- ❖ ndryshimin dhe/apo buxhetimin aty ku mungon, të kostos financiare për çdo aktivitet;
- ❖ realizimin e gjithërfshirjes së aktorëve të sistemit të drejtësisë në planifikimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit në përputhje me objektivat strategjike, por dhe në kuadër të fushës së përgjegjësisë të çdo institucioni.

VII. KONKLUZIONE

Realizimi i reformës në drejtësi është një proces i vazhdueshëm ndërsektorial, ku vetë përcaktimi dhe matja e treguesve përfundimtar të suksesit është kompleks, sidomos në një kuadër ligjor dhe institucional në reformim të vazhdueshëm.

Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane mbetet misioni i kësaj strategjie.

Gjatë kryerjes së procesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Ndër elementët më të rëndësishëm të cilët kanë ndikuar në realizimin e ulët të aktiviteteve të parashikuar në këtë Plan Veprimi janë si më poshtë:

- ❖ Moskrijimi në kohë i institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë si: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, SPAK dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Për më tepër, krijimi me vonesë i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë muajit dhjetor 2018 dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në muajin janar 2019, ka ndikuar në realizimin e ulët të aktiviteteve të Planit të Veprimit, i cili do të implementohet në vijim nga këto institucione. Për këtë arsye, duke qenë se një pjesë e madhe e aktiviteteve (rreth 65 nën-aktivitete në total) në këtë Plan Veprimi, kanë si institucione përgjegjëse për zbatimin e tyre pikërisht organet e reja të sistemit të drejtësisë, moskrijimi i tyre në kohë ka ndikuar në performancën e ulët të realizimit të Planit të Veprimit për këtë periudhë dhe njëkohësisht dhe në zbatimin e ulët të objektivave të përcaktuara në këtë strategji.

Gjatë kësaj periudhe, zbatimi dhe monitorimi, si dy procese të ndërlidhura që kanë orientuar Ministrinë e Drejtësisë drejt reflektimit dhe konkluzioneve, mund të përmendim ndër më kryesoret:

- ✚ Nevojën për miratimin e draft-Planit të Veprimit sa më parë.
- ✚ Nevojën për miratimin e draft-Pasaportës së Treguesve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.
- ✚ Hendeku financiar i Strategjisë mbetet ende problematik, si dhe prek direkt zbatueshmerinë e planit. Nevojitet prioritizimi i masave dhe mobilizimi i mekanizmave institucionalë për adresimin e hendekut financiar dhe gjetjes së burimeve financiare. Gjithashtu, ndërlidhja me PBA-në dhe parashikimi i mbulimit financiar nga Buxheti i Shtetit duhet të përmirësohet. Plani i ri i Veprimit duhet të trajtojë këto mangësi, duke adresuar kështu dhe raportimin financiar.
- ✚ Problematikë mbetet përgjegjshmëria e institucioneve për raportimin në kohë dhe me cilësi të informacionit mbi aktivitetet e Planit të Veprimit, si dhe informacionin mbi disbursimin financiar. Nevojitet një bashkëpunim më i lartë i Dhomave, në veçanti të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privatë, për të kontribuar dhe raportuar lidhur me implementimin e Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

VIII. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- ✚ Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit dhe rishikimit të Planit të Veprimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitutional.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- ✚ Ndërlidhja me procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që të sigurohet mbulimi i nevojshëm financiar nga Buxheti i Shtetit për ato masa që parashikohen të zbatohen nëpërmjet Buxhetit të Shtetit.
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

ANEKS 1

Ligjet e miratuara nga paketa prej 27 ligjesh janë si më poshtë vijon:

1. Ligji nr. 35/2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
2. Ligji nr. 36/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;*
3. Ligji nr. 37/2017 *“Kodi i Drejtësisë për të Mitur”;*
4. Ligji nr. 32/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar;*
5. Ligji nr. 69/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar”;*
6. Ligji nr. 70/2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;*
7. Ligji nr.43/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 “Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit”;*
8. Ligji nr. 44/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;*
9. Ligji nr. 42/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;*
10. Ligji nr. 38/2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;*
11. Ligji nr. 40/2017 *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;*
12. Ligji nr. 39/2017 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar”;*
13. Ligji nr. 41/2017 *“Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”;*
14. Ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;*
15. Ligji nr. 98/2017 *“Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”;*
16. Ligji nr.26/2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;*
17. Ligji 55/2018 *“Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;*
18. Ligji Nr.80/2018 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar;*

19. Ligji Nr.86/2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”;*
20. Ligji Nr. 110/2018 *“Për Noterinë”;*
21. Ligji Nr. 25/2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”;*
22. Ligji 26/2019 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”;*
23. Vendimi i Kuvendit Nr. 47/2019, datë 18.04.2019 *“Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 – 2023”.*

DRAFT

Plani i Veprimit

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

(Për periudhën janar - mars 2019)

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni përgjegjës	Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro)	Buxheti i alokuar për çdo aktivitet	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2019 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2019
Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë						
Aktivitet 1.01	Forcimi i statusit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, përfshirë ndihmës-magjistratët/ këshilltarët ligjorë në përputhje me standardet evropiane që sigurojnë emërim dhe zhvillim të karrierës që janë të bazuara në meritë, janë objektive dhe transparente (duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese). Ngritja e një sistemi të zhvillimit të karrierës për të gjithë profesionistët që janë pjesë e sistemit gjyqësor.					
1.01.b	Vënia në zbatim e ndryshimeve të niveleve të pagave dhe pagesave etj -Gjyqtarët e të gjitha gjykatave - Vënia në zbatim e ndryshimeve të niveleve të pagave dhe pagesave etj - prokurorët - Vënia në zbatim e ndryshimeve të niveleve të pagave dhe pagesave etj - ndihmës magjistratët.	(KLGJ, KLP) ZABGJ	4,478,567 3,186,864 470,721	284.366.451 lekë për 349 magjistratë 13.054.370 lekë për 32 ndihmës ligjorë/magjistratë	Në proces	Kanë ndryshuar pagat e magjistratëve për vitin 2019; referuar ligjit 96/2016, pagat e reja kanë hyrë në fuqi në 1 janar 2019. Për 3-mujorin 2019, buxheti i realizuar (fakt) në shpenzime personeli për 349 magjistratë (nr.fakt) është 284,366,451 Lekë ose 2,280,405 eur.; Kursi i këmbimit sipas BSH datë 11/04/2019 është 1 euro = 124,7 lekë. Për të njëjtën periudhë, buxheti i realizuar (fakt) në shpenzime personeli për 32 ndihmës ligjorë/ magjistratë (nr.fakt) është 13,054,370 lekë ose 104,686 eur.; Kursi i këmbimit sipas BSH datë 11/04/2019 është 1 euro = 124,7 lekë.
1.01.c	Analiza e nevojave për trajnim.	SHM, KLGJ, KLP			E realizuar	SHM: Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vlerësimi i nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
1.01.d	Krijimi i kurrikulave/ trajnimeve pilote.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse krijimi i kurrikulave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
1.01.e	Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve.	SHM		6.916.250 lekë	E realizuar	Trajnimet që lidhen me këtë objektivi, realizuar në periudhën janar-mars 2019, janë: Numri total i trajnimeve: 77 trajnime, 69 prej të cilave janë financuar nga buxheti i Shkollës së Magjistraturës dhe 8 janë financuar nga donatorët. Nr. total i pjesëmarrësve: 875 persona*, ndër të cilët 413 gjyqtarë, 188 prokurorë dhe 274 të tjerë. Në kategorinë "të tjerë" përfshihen: magjistratë të diplomuar, kandidatë për magjistratë, këshilltarë e ndihmës ligjorë, avokatë shteti, oficerë të policisë gjyqësore, avokatë, specialistë, lektorë. <i>*Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues.</i> Tematikat e zhvilluara në sesionet trajnuese janë nga fushat penale, civile, administrative si më poshtë: administrimi i gjykatave, falimentimi, të drejtat e njeriut, e drejta e BE-së, drejtësia penale për të mitur, pronësia, krimi mjedisor, trajnim

						trajnerësh, procedura civile dhe penale, trafikimi i qënieve njerëzore, dhuna në familje, pronësia intelektuale, etika profesionale, terrorizmi, shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar etj.
1.01.f	Trajnimi i anëtarëve të këshillave.	<i>KLJG</i>			Në proces	Me mbështetjen e misionit EURALIUS V dhe USAID, si dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, janë kryer një numër trajnimesh me anëtarët e KLGJ mbi planifikimin strategjik, menaxhimin e sistemit gjyqësor, etj.
1.01.g	Trajnimi i nëpunësve civile që janë pjesë e sistemit gjyqësor.	<i>SHM</i>			E realizuar	E realizuar gjatë vitit 2018. Nuk ka zhvillime të reja për periudhën janar-mars 2019.
Aktivitet 1.02	Vënia në zbatim e ndryshimeve të sistemit dhe ndryshimeve organizative me qëllim përmirësimin e funksionimit dhe të efikasitetit në kuadër të ndryshimeve kushtetuese.					
1.02.c	Vënia në zbatim e ndryshimeve organizative, hartimi i sistemeve dhe procedurave - Hartimi i sistemeve dhe procedurave Kosto e vënies në zbatim Kosto stafi si pasojë e rritjes së pagës.	<i>GJK</i>	25,000 34,699		E paraportuar	
1.02.e re	Kosto stafi për 9 këshilltarë shtesë.	<i>GJK</i>	60,000		E paraportuar	
Aktiviteti 1.03	Krijimi i një inspektorati të vetëm të pavarur përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane.					
1.03.b	Ndërtesë dhe infrastrukturë e re për inspektoratin Mobilim i Inspektoratit Makina për Inspektoratin.	<i>ILD</i>			E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.c	Pajisje të IT për inspektoratin.	<i>ILD</i>			E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.d	Krijimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve për Inspektoratin e Lartë (menaxhimi i rasteve të inspektimit, ankesave dhe masave disiplinore.	<i>ILD</i>			E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.d-e re	Kosto korrente për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve për Inspektoratin e Lartë.	<i>ILD</i>	20,000		E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.e	Rekrutimi i punëmarrësve.	<i>ILD</i>	989,400		E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.f	Analiza e nevojave të trajnimit.	<i>ILD</i>			E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.g	Krijimi i kurrikulave / trajnimeve pilot.	<i>ILD</i>	35,000		E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
1.03.h	Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme.	<i>ILD</i>			E përealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.

1.03.i	Akresi tek bazat ndërkombëtare të të dhënave /bibliotekave.	ILD	20,000		E parealizuar	Për shkak të moskrijimit të ILD-së.
Aktivitet 1.04	Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe e autoriteteve të tjera hetimore dhe shpërndarja e gjykatave, në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe bllokimi i çështjeve gjyqësore, me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar aksesin në drejtësi.					
1.04.a	Adaptimi i infrastrukturës në gjykata dhe prokurori me hartën e re gjyqësore duke mbyllur gjykata apo duke adaptuar të tjera.	KLJG, KLP	125,000		Në proces	Bazuar në urdhërin nr. 78, të Kryetares së KLJG është ngritur një grup pune me ekspertë nga KLJG, Ministria e Drejtësisë, gjykata të niveleve të ndryshme dhe me mbështetjen e EURALIUS V dhe USAID. Janë zhvilluar deri më tani 3 takime dhe janë përcaktuar kriteret bazë mbi të cilat do të shqyrtohet ndarja e re territoriale. Ndryshimi i hartës gjyqësore dhe riorganizimi i gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, është në proces. Me përfundimin e tij, do të realizohet adaptimi i infrastrukturës në gjykata, duke analizuar gjëndjen ekzistuese dhe mundësitë konkrete sipas rastit.
1.04.b	Organizimi i migrimit të çështjeve.	KLJG, KLP	6,000		E parealizuar	Në kuadër të realizimit më parë të aktivitetit 1.04.a.
Aktivitet 1.05	Zbatimi i kornizës së re ligjore për rritjen, forcimin dhe përmirësimin e organizimit të gjykatës dhe administratës gjyqësore për të arritur standardet evropiane të praktikave më të mira.					
1.05.a	Identifikimi i standardeve evropiane dhe ofrimi i një analize të boshllëqeve.	MD, KLJG, KM			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
1.05.b	Vlerësimi i nevojave për trajnim.	SHM, KLJG			E realizuar	SHM: Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vlerësimi i nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
1.05.c	Përpunimi i kurrikulave /trajnimet pilot.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse përpunimi i kurrikulave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
1.05.d	Krijimi i një kursi trajnimi fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit e gjykatës (shih Objektivin 2, pika 2).	SHM, KLJG, KLP			E parealizuar	Duke pasur në vëmendje faktin që kjo është në përgjegjësi të KLJG dhe KLP, SHM është në pritje të fillimit të koordinimit nga dy institucionet përgjegjëse.
1.05.d+e	Rekrutimi i trajnuesve / Krijimi i një kursi trajnimi fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit e gjykatës (shih Objektivin 2, pika 2).	SHM, KLJG, KLP	30,000	77.000 lekë	E realizuar	Lidhur me organizimin në gjykata dhe administratën gjyqësore janë zhvilluar 3 aktivitetet trajnuese në lidhje me eficientën gjyqësore dhe menaxhimin aktiv të çështjeve; menaxhimin e burimeve njerëzore; standardet dhe matja e performancës së gjykatave. Nga këto trajnime, 1 është organizuar nga buxheti i Shkollës dhe 2 të tjerët nga donatori. Numri total i pjesëmarrësve ka qenë 33 persona, prej të cilëve 4 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 24 të tjerë.
1.05.f	Përgatitja e rregullave dhe akteve nënligjore.	KLJG, KLP			Në proces	KLJG ka marrë një sërë iniciativash dhe në këtë kuadër janë miratuar rregulla të detajuara mbi: <ul style="list-style-type: none"> • Vendim Nr.1 datë 20.12.2018 - Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të këshillit të lartë gjyqësor. • Vendim Nr.7 datë 21.12.2018: Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave. • Vendim Nr.13 datë 18.01.2019: mbi ngritjen dhe përbërjen e komiseve të përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor • Vendim Nr.14 datë 22.01.2019: mbi fillimin e procesit të krijimit të skemës së delegimit • Vendim nr.15 datë 22.01.2019: ngritjen e komisionit të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të

					<p>rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendim Nr.22 datë 7.02.2019: Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të delegimit të gjyqtarit • Vendim Nr.23 datë 7.02.2019: Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit • Vendim Nr.24 datë 7.02.2019: Mbi miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve • Vendim Nr.25 datë 7.02.2019: mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore • Vendim Nr.30 datë 14.02.2019: mbi miratimin e vendimit për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në menyrë të përhershme • Vendim nr.31 datë 14.02.2019: mbi ngritjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari • Vendim Nr.35 datë 19.02.2019: për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në menyrë të përhershme • Vendim Nr.38 datë 28.02.2019: për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare. • Vendim Nr.52 datë 27.03.2019: për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-këshillit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. <p>KLP: Miratuar rregullorja për ngritjen në detyrë për prokurorët në Prokurorinë e Posacme. Miratuar rregullorja për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Miratuar rregullorja për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve.</p>	
Aktivitet 1.06	Rritja e funksionimit të KLGJ dhe zgjerimi i objektivit të kompetencave të tij, duke i bërë gjykatat më të larta pjesë të objektivit të saj dhe duke zgjeruar funksionet, p.sh. në lidhje me TI, buxhetin gjyqësor, administrimin e gjykatave, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun në bazë të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare.					
1.06.c	Rekrutimi i punonjësve me integritet të lartë profesional dhe etik Shpenzime operacionale dhe për mobilim Pajisj TI për zyrat 5 makina.	<i>KLJG</i>	631,693		Në proces	KLJG ka miratuar strukturën organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe po planifikon plotësimin e saj me punonjës me integritet të lartë profesional dhe etik. Njëkohësisht po bëhet ç'është e mundur që hapësirat ekzistuese të zyrave të përshtaten për një pjesë të stafit që pritet të rekrutohet, në pritje të një sistemimi më të përshtatshëm ku të mund të akomodohet i gjithë stafi.
1.06.d	Analiza e nevojave të trajnimit.	<i>KLJG</i>			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
1.06.e	Krijimi i kurrikulave/ trajnimit pilot.	<i>KLJG</i>			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
1.06.f	Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme.	<i>KLJG, KLP</i>			Në proces	KLJG dhe KLP kanë marrë një sërë iniciativash dhe në këtë kuadër janë miratuar disa rregulla. Lutem referojuni nën-aktivitetit 1.05.f
1.06.g	Aksesi në bazat e të dhënave / bibliotekat ndërkombëtare.	<i>KLJG</i>			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
1.06.h	Trajnimi i nëpunësve civil të sistemit gjyqësor.	<i>KLJG</i>			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.

Aktivitet 1.07	Krijimi i KLP dhe ngritja e kapaciteteve në bazë të standardeve moderne evropiane dhe zbatimi i ndryshimeve të fundit ligjore.					
1.07.a	Identifikimi i godinës, specifikimet e projektit dhe plani i zhvendosjes.	KLP			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
1.07.c	Rekrutimi i punonjësve me integritet të lartë profesional dhe etik Shpenzime të tjera Makina (5) Software, pajisje TI.	KLP	528,571		E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
1.07.d	Analiza e nevojave të trajnimit.	KLP			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
1.07.e	Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme.	KLP			Në proces	Miratuar rregullorja për ngritjen në detyrë për prokurorët në Prokurorinë e Posacme. Miratuar rregullorja për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Miratuar rregullorja për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve.
1.07.f	Akresi në bazat e të dhënave /bibliotekat ndërkombëtare.	KLP			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
Aktivitet 1.08	Rritja e efikasitetit të Gjykatës së Lartë dhe zvogëlimi i barrës së çështjeve sipas standardeve të njohura evropiane për efikasitetin e gjykatave.					
1.08.c	Akses në libraritë dixhitale ligjore.	KLJG			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
1.08.d	Trajnim i stafit administrativ.	KLJG			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
Aktivitet 1.09	Krijimi i një Këshilli të Emërimeve në gjyqësor me qëllim që të rishikojë CV-të e anëtarëve të institucioneve të drejtësisë që zgjidhen nga Parlamenti me qëllim reduktimin e ndikimit politik.					
1.09.e	Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme.	KED			E realizuar	<p>KED ka filluar punën zyrtarisht në datë 15.01.2019 dhe për periudhën 3 mujore, ka realizuar një punë voluminoze, delikate dhe produktive, duke miratuar këto akte:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Rregulloren e Brendshme “Për Funkcionimin e KED”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 08.02.2019; 2- Vendimin Nr. 2, Datë 15.02.2019 “Procedurën e Shortit të Caktimit të Relatorëve për Pozicionet Vakante në çdo Institucion”; 3- Vendimin Nr. 4, Datë 11.03.2019 “Për Procedurën e Verifikimit të Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”; 4- Vendimin Nr. 5, Datë 02.04.2019 “Për Kriteret dhe Procedurën e Vlerësimit, Pikëzimit dhe Renditjes së Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”; <p>KED, ka miratuar të gjithë aktet dhe rregulloret e nevojshme për iniciimin e procesit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Akti i fundit është miratuar në datë 02.04.2019.</p> <p><i>Sipas neni 219/3 të ligji nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, KED mbështetet nga Gjykata e Lartë për të gjithë masat dhe infrastrukturën e nevojshme gjatë veprimtarisë së tij.</i></p> <p><i>Këshilli të Emërimeve në Drejtësi, gjatë kësaj periudhe 3 mujore ka paraqitur kërkesë për caktim fondesh dhe akoma nuk i është alokuar asnjë fond</i></p>

					<i>nga buxheti i shtetit dhe/ose donator.</i>
1.09.f	Aksesi në bazat e të dhënave dhe manualet ndërkombëtare.	KED	20,000	E realizuar	<p>Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në faqen e Gjykatës së Lartë, ka rubrikën e vet, ku është baza e të dhënave e nevojshme dhe e aksesueshme për të gjithë personat e interesuar.</p> <p>Në këtë faqe janë pasqyruar të gjitha mbledhjet e zhvilluar nga ana e këshillit, aktet e miratuara prej tij, listat me emërat përkatës të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për një nga pozicionet në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, dokumentacioni i nevojshëm që duhet plotësuar dhe dorëzuar nga të gjithë kandidatët, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm me qëllim bërjen publike dhe transparente të të gjithë procesit.</p> <p>Duhet theksuar se kjo bazë të dhënash gjatë gjithë kohës është në përditësim dhe rregullim të vazhdueshëm duke e bërë aksesin edhe më të thjeshtuar dhe gjithëmonë në kuadër të transparencës.</p> <p><i>Sipas neni 219/3 të ligji nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", KED mbështetet nga Gjykata e Lartë për të gjithë masat dhe infrastrukturën e nevojshme gjatë veprimtarisë së tij.</i></p> <p><i>Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, gjatë kësaj periudhe 3 mujore ka paraqitur kërkesë për caktim fondesh dhe akoma nuk i është alokuar asnjë fond nga buxheti i shtetit dhe/ose donator.</i></p>
Aktivitet 1.10	Përmirësimi i sistemit të arkivës të gjyqësorit nëpërmjet zbatimit dhe funksionimit të arkivës qendrore të gjykatave.				
1.10.c	Përmirësimet e IT.	MD (KLGJ, për t'u konfirmuar) AKSHI, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor.	25,000	E realizuar	<p>Në janar të vitit 2018, në zbatim të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", AKSHI ka mundësuar ofrimin e shërbimit të internetit për Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.</p> <p>Në prill të vitit 2018, në bazë të Rregullores së Administrimit të Domaineve nën: .al dhe nën domainet .com.al, .org.al, .gov.al, .edu.al, .mil.al dhe .net.al e miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues ERT Nr. 437 datë 21.02.2008, AKEP ka mundësuar rregjistrimin e emrit të domain-it: ashsgj.gov.al.</p> <p>Në prill të vitit 2018, në zbatim të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", AKSHI ka mundësuar instalimin e qendëruar të programit Symantec Endpoint Protection për 6 përdorues (nëpunës të ASHSGJ-së).</p> <p>Në maj të vitit 2018, në zbatim të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", AKSHI ka mundësuar hostimin e domainit dhe ofrimin e postës elektronike për punonjësit e ASHSGJ-së, si dhe në Janar 2019, ASHSGJ në bashkëpunim me AKSHI-n, bëri të mundur publikimin e faqes zyrtare të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor: www.ashsgj.gov.al</p>
1.10. e re	Burime njerëzore për dixhitalizimin dhe hedhjen e të dhënave.	MD (KLGJ, për t'u konfirmuar)		E parealizuar	Proçesi i dixhitalizimit nuk ka filluar ende, si rrjedhojë ASHSGJ nuk ka burime njerëzore për dixhitalizimin dhe hedhjen e të dhënave.

Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.

Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni përgjegjës	Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro)	Buxheti i alokuar për çdo aktivitet	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2019 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2019
Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave						
Aktivitet 2.01	Zbatimi i një kuadri ligjor për një provim shteti për juristët, si një parakusht për profesionet ligjore (magjistratët, prokurorët, avokatët, noterët, përmbartesit, avokatët e shtetit dhe nëpunësit civilë).					
2.01.b	Krijimi i strukturave të nevojshme organizative.	MD			E parealizuar	Nuk ka zhvillime pasi kjo nismë është tërhequr nga deputeti propozues.
2.01.e	Krijimi i sistemit për provimin e shtetit për juristët.	MD			E parealizuar	Nuk ka zhvillime pasi kjo nismë është tërhequr nga deputeti propozues.
2.01.f	Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme.	MD			E parealizuar	Në varësi të nën-aktivitetit 2.01.e.
Aktivitet 2.02	Thellimi dhe zgjerimi i objektit të aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me: - Trajnimin fillestar të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë (specializim, profesionalizëm më i thellë, dhe më shumë profesionalizëm dhe etikë) - Trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ligjin e BE-së - Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm për kategoritë e ndryshme të punonjësve të gjykatës. - Programe trajnimi të detyrueshme për stafin e institucioneve që kryejnë funksione ndihmëse.					
2.02.a	Vlerësimi i nevojave për trajnim.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vlerësimi i nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
2.02.b	Vlerësimi i kapaciteteve trajnuese dhe kapaciteteve financiare.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vlerësimi i kapaciteteve për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
2.02.c	Zhvillimi i kurrikulës së përmirësuar dhe programeve trajnuese.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse zhvillimi i kurrikulës së përmirësuar për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
2.02.d	Përmirësimi i metodave të vlerësimit dhe certifikimit të kualifikimeve profesionale gjatë trajnimit fillestar dhe atij vazhdues.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse përmirësimi i metodave të vlerësimit për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
2.02.e	Zbatimi i kurrikulave të rishikuara dhe programeve të trajnimit	SHM	50,000	6.916.250 lekë	E realizuar	Zbatimi i kurrikulave të rishikuara është realizuar nga pedagogët e Shkollës në Programin e Formimit Fillestar dhe ka pasur një kosto prej 0 lekë. Në Programin e Trajnimit Fillestar, me kandidatët për magjistrat, është zhvilluar një trajnim, si më poshtë vijon: 19-20 mars 2019 Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, interesi më i lartë i fëmijës, shmangia dhe dënimet ndaj të miturve – me fokus tek legjislati dhe me mbështetje nga ekspertë gjyqtarë/prokurorë që mund të sjellin shembuj nga zbatimi në praktikë. Në Programin e Formimit Vazhdues, trajnimet që lidhen me këtë objekt, realizuar në periudhën janar-mars 2019, janë: Numri total i trajnimeve: 77 trajnime, 69 prej të cilave janë financuar nga buxheti i Shkollës së Magjistraturës dhe 8 janë financuar nga donatorët. Numri total i pjesëmarrësve: 875 persona*, ndër të cilët 413 gjyqtarë, 188 prokurorë dhe 274 të tjerë. Në kategorinë “të tjerë” përfshihen: magjistratë të diplomuar, kandidatë për magjistratë, këshilltarë e

						ndihmës ligjorë, avokatë shteti, oficerë të policisë gjyqësore, avokatë, specialistë, lektorë. *Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magistrati në të paktën një sesion trajnues. Tematikat e zhvilluara në sesionet trajnuese janë nga fushat penale, civile, administrative si më poshtë: administrimi i gjykatave, falimentimi, të drejtat e njeriut, e drejta e BE-së, drejtësia penale për të mitur, pronësia, krimi mjedisor, trajnim trajnerësh, procedura civile dhe penale, trafikimi i qënieve njerëzore, dhuna në familje, pronësia intelektuale, etika profesionale, terrorizmi, shkrimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar etj.
2.02.g	Gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë marrin pjesë në trajnime në ERA.	SHM			E realizuar	E realizuar gjatë vitit 2018. Nuk ka zhvillime të reja për periudhën janar-mars 2019.
Aktivitet 2.03	Transformimi gradual i Shkollës së Magistraturës në një qendër burimore dhe pike takimi për të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndryshimi i vendndodhjes, përshtatja e godinës dhe blerja e pajisjeve.					drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën
2.03.a	Identifikimi i nevojave për biblioteka/ baza të dhënash.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse identifikimi i nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
2.03.d	Buxhete për libra dhe revista.	SHM	5,000		E realizuar	E realizuar gjatë vitit 2018. Nuk ka zhvillime të reja për periudhën janar-mars 2019.
2.03.f	Kosto për përshtatjen ambienteve.	SHM			E parealizuar	Për periudhën janar-mars 2019 nuk ka pasur fonde për këtë aktivitet.
2.03.e re	Ndërtimi i ambienteve të reja për Shkollën e Magistraturës, përfshirë mobilimin.	SHM	2,000,000		Në proces	Gjatë periudhës janar-mars 2019, projekti i ndërtimit të godinës së Shkollës së Magistraturës është në proces dhe po ndiqet nga AKPT.

Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.

Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni përgjegjës	Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro)	Buxheti i alokuar për çdo aktivitet	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2019 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2019
Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.						
Aktivitet 3.01	Përmirësimi i legjislacionit me qëllim përmirësimin e efikasitetit të procedurave gjyqësore në veçanti nëpërmjet: -përmirësimi të sistemit të njoftimeve; - sigurimit të mjeteve që parandalojnë shtyrjen e gjykimeve, - futjes së procedurave të përshpejtuara - kritereve të filtrimit - kërkimit të arsyetimit në të njëjtën kohë me vendimin e gjykatës / me shpalljen e vendimit.					
3.01.c	Regjistrimi i Domain.	Kuvendi	2,000		Për rishikim	Duhet të rishikohet institucioni përgjegjës për këtë aktivitet. Bazuar në nenin 133 të Kodit të Procedurës Civile, portali elektronik kombëtar për kryerjen e njoftimeve krijohet dhe administrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.
3.01.f	Analiza e nevojave të trajnimit.	SHM	5,000		E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse analiza e nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
3.01.g	Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot.	SHM	5,000	225.500 lekë	E realizuar	Janë krijuar kurrikula për disa trajnime lidhur me këtë objektivi dhe janë zhvilluar 5 trajnime në lidhje me efikasitetin gjyqësor dhe menaxhimin aktiv të çështjeve; mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë; menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe standardet dhe matja e performancës së

						gjykatave. Nga trajnimet e zhvilluara, 3 janë financuar nga buxheti i Shkollës, ndërsa 2 të tjerat janë financuar nga donatori. Numri total i pjesëmarrësve në këto trajnime është 55 persona, prej të cilëve 11 gjyqtarë, 9 prokurorë dhe 35 të tjerë.
3.01.h	Fushata të ndërgjegjësimit.	MD	5,000		E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
Aktivitet 3.02	Krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e aksesit në gjykatë.					
3.02.a	Rishikimi i draftit nën dritën e konsultimit.	Kuvendi			E realizuar	Në fazën e draftimit të tij ligji nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi me institucionet e fushës, ministrinë e linjës dhe grupet e interesit etj. Kuvendi i Shqipërisë, në datën 2 nëntor 2017 miratoi ligjin Nr.98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”. Për më tepër informacion, lutem referojuni Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2018.
3.02.b	Miratimi i draftit nga Parlamenti.	Kuvendi			E realizuar	Kuvendi i Shqipërisë, në datën 2 nëntor 2017 miratoi ligjin Nr.98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”. Për më tepër informacion, lutem referojuni Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2018.
Aktivitet 3.03	Krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës juridike falas për individët dhe grupet në nevojë.					
3.03.e	Miratimi i draftit nga parlamenti.	Kuvendi			E realizuar	Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 14.12.2017, miratoi ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Për më tepër informacion, lutem referojuni Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2018.
3.03.f	Fushata e ndërgjegjësimit.	KLJGJ, MD, Dhoma Kombëtare e Avokatisë	5,000		Në proces	Bashkëpunimi mes KLJGJ dhe Ministrisë së Drejtësisë ka nisur në përbushje të këtij objekti dhe konkretisht me përcaktimin e qendrave të para për ofrimin e ndihmës juridike falas në rrethet Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Durrës, pranë ambienteve të gjykatave respektive të shkallës së parë të rretheve.
3.03.g	Analiza e nevojave të trajnimit.	SHM (për gjyqtarët), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (avokatët)	10,000		E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vlerësimi i nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
3.03.h	Krijimi i kurrikulës / trajnimit pilot.	SHM (për gjyqtarët), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (avokatët)	20,000		E realizuar	SHM: Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse krijimi i kurrikulës për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar. DHKA: Për periudhën janar – mars 2019 është organizuar trajnimi 3 mujor online mbi “Drejtësinë Miqësore për të Miturit dhe të Drejtat e Fëmijëve” e organizuar nga DHKA në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës. Modulet e trajnimit, pjesëmarrësit dhe rezultatet përfundimtare të këtij trajnimi i janë dërguar Ministres së Drejtësisë, me shkresë zyrtare nga Këshilli i Europës. Sa i takon detyrimin të DHKA lidhur me nenin 9/d të ligjit nr.111/2017, lista e avokatëve të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar ndihmë juridike (përfshirë edhe për të miturit), i është dërguar

						Ministrisë së Drejtësisë. 194 avokatë nga të gjitha Dhomat e Avokatisë kanë bërë kërkesë për të shërbyer si avokatë për të miturit dhe nëse kjo listë do të miratohet dhe nga Drejtoria e Ndhmës Juridike pranë MD-së, DHKA do të fillojë shumë shpejt trajnimin e tyre. Përsa më sipër, DHKA ka nënshkruar dhe një MoU me organizatën Terre des Hommes për organizimin e këtyre trajnimeve, si dhe për përgatitjen e protokolleve të trajnimit për avokatët që do të shërbejnë për të miturit.
3.03.i	Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit administrativ.	SHM (për gjyqtarët), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (avokatët)	40,000		E realizuar	E realizuar gjatë vitit 2018. Nuk ka zhvillime të reja për periudhën janar-mars 2019.
3.03.new	Buxheti për ndihmën juridike.	(KLGJ, MD, Dhoma Kombëtare e Avokatisë) Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas	1,500,000	1.229.455 lekë	E realizuar	Buxheti faktik për 3 mujorin e parë të vitit 2019 të KSHNJ është 1.229,455 lekë. Nga këto: 1.033,259 lekë janë shpenzime për pagat, 153,567 lekë shpenzime për sigurimet dhe 42,629 shpenzime për mallra dhe shërbime. Ndërkohë që me Urdhrin nr. 59 datë 25.03.2019, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas" është miratuar struktura e Drejtorisë së re dhe ka nisur menjëherë procesi i ristrukturimit të strukturës ekzistuese. Për vitin 2019 buxheti i parashikuar për ndihmën juridike është 76 milion lekë.
Aktivitet 3.04	Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet gjykatës dhe medias dhe sigurimi i aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik.					
3.04.f	Krijimi dhe projektimi i faqeve të internetit, mirëmbajtja e faqeve të internetit.	KLGJ	10,000		Në proces	Me mbështetjen e USAID po përgatitet një faqe zyrtare interneti për KLGJ. Portali i gjyqësorit, që do të përfshijë të gjithë sistemin, mbetet për tu konsideruar në vijim.
3.04.g	Zbatimi i rregullave të reja për marrëdhëniet me median.	KLGJ ose institucioni përkatës me ligj			E përealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.

Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni përgjegjës	Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro)	Buxheti i alokuar për çdo aktivitet	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2019 (E realizuar/në proces/përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2019
Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.						
Aktivitet 4.01	Rritja e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve dhe prokurorisë (sipas standardeve evropiane) duke rishikuar kompetencat e hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykatë dhe duke promovuar kontrollin efektiv dhe ekuilibrin e këtyre kompetencave nga strukturat përgjegjëse.					
4.01.a	Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme.	MD, PP			Në proces	Janë në proces draftimi udhëzime të përgjithshme dhe rregullorja e organizimit dhe funksionimit të prokurorive, në përputhje me strukturën e vitit 2019.
4.01.b	Analiza e nevojave për trajnim.	MD, PP			E realizuar	Në nivel institucional bashkëpunohet me projektet që asistojnë prokurorinë për zhvillimin e trajnimeve. Projekti Pameca V ka zhvilluar dy aktivitete

						trajnuese me temë, mbi ligjin antimafia dhe hetimin e narkotikëve. Gjithashtu, në zbatim të ligjit 115/2016, prokurorët i drejtojnë drejtëpërdrejtë nevojat për trajnim Shkollës së Magjistraturës.
4.01.c	Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot.	MD, PP			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
4.01.d	Fushata sensibilizuese	MD, PP			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
Aktivitet 4.02	Krijimi i një strukture të specializuar anti-korrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.					
4.02.b	Hartimi i një strukture të re organizative dhe kostot përkatëse Manual Rekrutimi i stafit Shpenzime operative (shpenzime për staf mbështetës).	KLJGJ, KLP, SPAK	1,150,000 214,285		Në proces	Në mbledhjen e datës 27.12.2018, Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrtoi me prioritet funksionimin e Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga ligji, Këshilli vendosi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke i hapur rrugë krijimit të këtyre gjykatave.
4.02.c	Kontrollet e sigurisë për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore.	KLJGJ, KLP, SPAK			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
4.02.d	Analiza e nevojave të trajnimit. Sistemi elektronik funksional.	SHM, KLJGJ, KLP, SPAK			E realizuar	SHM: Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vlerësimi i nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
4.02.f	Trajnimi i anëtarëve të SPAK dhe stafit administrativ. Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot.	SHM		591.250 lekë	E realizuar	Pavarësisht faktit që Gjykata dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk janë konstituuar akoma, Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar 5 trajnime rreth veprave penale që janë kompetencë e këtyre organeve, të gjitha të financuara nga buxheti i Shkollës. Numri total i pjesëmarrësve është 79 persona*, ndër të cilët 29 gjyqtarë, 32 prokurorë ¹² dhe 18 të tjerë. Në kategorinë “të tjerë” përfshihen magjistratë të diplomuar, kandidatë për magjistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, avokatë shteti, oficerë të policisë gjyqësore, inspektorë pranë KLJGJ, avokatë privatë, specialistë, lektorë. * Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues.
Aktivitet 4.03	Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe zbatim i tyre, për ta sjellë atë në përputhje me standardet evropiane.					
4.03.c	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për amendamentet e Kodit të Procedurës Penale.	MD			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
4.03.d	Analiza e nevojave të trajnimit.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse analiza e nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
4.03.e	Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot.	SHM			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse krijimi i kurrikulave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
4.03.f	Trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe stafit administrativ.	SHM		1.991.000 lekë	E realizuar	Trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës mbi tema të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në periudhën Janar-Mars 2019 janë 21 në total, 20 prej të cilave të financuara nga

¹² Nga 25 kandidatë të SPAK, 9 prej tyre janë të përfshirë në proces si pjesëmarrës, ekspertë ose lehtësues.

						<p>buxheti i Shkollës dhe 1 është financiar nga donatori, ku temat janë të ndryshme, si: rishikimi i vendimit penal si mjet ankimi; efienca gjyqësore dhe menaxhimi aktiv i çështjeve; drejtësia penale për të mitur; reformimi i gjykimit penal në Apel; përgjegjësia civile dhe penale e organeve të shoqërisë tregtare; veprat penale në fushën e tatimeve; pjesëmarrja e të pandehurit në procesin penal; korrupsioni dhe legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar në këtë fushë etj.</p> <p>Numri total i pjesëmarrësve është 272 persona*, ndër të cilët 115 gjyqtarë, 105 prokurorë dhe 52 të tjerë. Në kategorinë "të tjerë" përfshihen magistratë të diplomuar, kandidatë për magistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, avokatë shteti, oficerë të policisë gjyqësore, inspektorë pranë KLGj, avokatë privatë, specialistë, lektorë.</p> <p>* Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magistrati në të paktën një sesion trajnues.</p>
Aktivitet 4.04	Përmirësimi i legjislacionit penal në përputhje me standardet evropiane.					
4.04.b	Përfundimi i amendimeve të kodit të procedurës penale dhe kodit penal.	<i>Kuvendi</i>			E realizuar	<p>Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në datë 30.03.2017 ligjin nr.35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" dhe ligjin nr.36/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".</p> <p>Për më tepër informacion, lutem referojuni Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2018.</p>
4.04.c	Konsultimi për kodet.	<i>Kuvendi</i>			E realizuar	<p>Procesi i hartimit dhe konsultimit të ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar" dhe ligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar" ka respektuar parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit të gjerë midis gjithë aktorëve në këtë proces.</p> <p>Për më tepër informacion, lutem referojuni Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2018.</p>
4.04.d	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për Kodin e ri Penal.	<i>MD</i>			E porealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
4.04.f	Analiza e nevojave për trajnim. Ofrimi i komentareve për kodin e ri.	<i>SHM, MD</i>			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse analiza e nevojave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
4.04.g	Vendosja e kurrikulave / trajnimit pilot.	<i>SHM</i>			E realizuar	Ky aktivitet konsiderohet i realizuar sepse vendosja e kurrikulave për vitin akademik 2018-2019 ka përfunduar.
4.04.h	Trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe stafit administrativ.	<i>SHM</i>		1.991.000 lekë	E realizuar	Trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës mbi tema të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në periudhën Janar-Mars 2019 janë në 21 në total, 20 prej të cilave të financuara nga buxheti i Shkollës dhe 1 është financiar nga donatori, ku përfshihen tema të ndryshme, si: rishikimi i vendimit penal si mjet ankimi; efienca gjyqësore dhe menaxhimi aktiv i çështjeve; drejtësia penale për të mitur; reformimi i gjykimit

						<p>penal në Apel; përgjegjësia civile dhe penale e organeve të shoqërisë tregtare; veprat penale në fushën e tatimeve; pjesëmarrja e të pandehurit në procesin penal; korrupsioni dhe legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar në këtë fushë etj.</p> <p>Numri total i pjesëmarrësve është 272 persona*, ndër të cilët 115 gjyqtarë, 105 prokurorë dhe 52 të tjerë. Në kategorinë “të tjerë” përfshihen magistratë të diplomuar, kandidatë për magistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, avokatë shteti, oficerë të policisë gjyqësore, inspektorë pranë KLGj, avokatë privatë, specialistë, lektorë.</p> <p>* Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magistrati në të paktën një sesion trajnues.</p>
Aktivitet 4.05.	Forcimi i kapaciteteve të Prokurorisë së Përgjithshme që të realizojë në mënyrë sa më efektive procesin e dekriminalizimit siç përcaktohet në ligj.					
4.05.b	Punësimi i 2 prokurorëve dhe i 2 nëpunësve civilë.	PP	59,649		E realizuar	Prej marsit 2016 brenda numrit të punonjësve është ngritur dhe funksionon sektori i verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
4.05.c	Hartimi i kurrikulave dhe trajnim i stafit.	PP			E parealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
4.05.d	Sigurimi i pajisjeve.	PP			E realizuar	Punonjësve u janë siguruar pajisjet e nevojshme të zyrës.
Aktivitet 4.06	Mbështetje për strategjinë e përgjithshme anti-korrupsion brenda Ministrisë dhe sistemit të drejtësisë për të arritur tek një nivel i performancës organizative në përputhje me standardet europiane.					
4.06.e r1	Analiza e nevojave për trajnim.	MD			E realizuar	Në vijim të analizave të bëra nga ana e sektorëve dhe struktura antikorrupsion në MD, në bashkëpunim me Projektin Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e antikorrupsionit” por edhe me partnerë të tjerë si OSCE (Organization for Security and Cooperation in Europe), është pasuruar axhenda e parashikuar e trajnimeve për antikorrupsionin. Është zgjeruar kurrikula dhe tematikat e trajnimit dhe janë përfshirë një target më i gjërë pjesëmarrësish në trajnime.
4.06.e re3	Trajnim i stafit.	MD			E realizuar	Gjatë muajit shkurt 2019 janë trajnuar 11 trajnerë për pikat e kontaktit antikorrupsion nga Projekti Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e antikorrupsionit”.
						Në datat 4-5 mars 2019 dhe 11-12 mars 2019 janë trajnuar 32 persona, pika kontakti antikorrupsion në vlerësimin e rrishtit për korrupsion dhe zbatimin e masave antikorrupsion.
						Në datat 28-29 Mars 2019 është zhvilluar trajnimi në bashkëpunim me OSCE (Organization for Security and Cooperation in Europe) mbi mjetet për parandalimin e korrupsionit dhe planet e integritetit. Trajnimi u zhvillua me pjesëmarrjen e pikave të kontaktit antikorrupsion nga të gjitha institucionet që zbatojnë masat në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.

Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni përgjegjës	Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro)	Buxheti i alokuar për çdo aktivitet	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2019 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2019
Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.						
Aktivitet 5.01	Krijimi i një platforme të TI për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit.					
5.01.a	Krijimi i një qendre të përpunimit të të dhënave.	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)			Në proces	Euralius: Një studim paraprak është kryer nga Euralius mbi Justnet.
5.01.b	Krijimi i rrjetit të një zone të gjerë të gjyqësorit (JustNET) (kosto operacionale). Krijimi i rrjetit të një zone të gjerë të gjyqësorit (JustNET).	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)	100,000		Në proces	Euralius: Një studim paraprak është kryer nga Euralius mbi Justnet.
5.01.c	Sigurimi i pajisjeve të TI për përdoruesit fundorë (Just-net).	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)			E parealizuar	Në varësi të nën-aktivitetit 5.01.a dhe 5.01.b.
5.01.d	Sigurimi i mirëmbajtjes së qendrës së të dhënave.	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)	100,000		E parealizuar	Në varësi të nën-aktivitetit 5.01.a, 5.01.b dhe 5.01.c.
Aktivitet 5.02	Përmirësimi i operacioneve të TI dhe shërbimeve mbështetëse për sistemet elektronike në gjyqësor (Krijimi i operacioneve të centralizuara TI dhe qendrës mbështetëse (ITOSC) që mbulojnë sistemet e TI të gjykatave, KLGj, KLP, ILD dhe Këshillit të Emërimeve).					
5.02.a	Sigurimi i burimeve njerëzore.	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)	67,676		E parealizuar	<p>Është përgatitur Projekt VKM dhe relacioni nga Ministria e Drejtësisë për ngritjen e qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë. Projekt akti përcakton rregullat për krijimin, organizimin dhe organet përgjegjës që do të kontribuojnë për funksionimin efektiv të teknologjisë së informacionit dhe sistemit të të dhënave në sistemin e drejtësisë. Për hartimin e kësaj Projekt VKM kanë kontribuar Euralius dhe Justice for All nga USAID. Ky projektvendim i kushton një rëndësi të veçantë mbrojtjes dhe ruajtjes së të dhënave, sigurisë, privatësisë, aksesit dhe transparencës në përdorimin e të dhënave</p> <p>Për këtë qëllim ngrihet Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, e cila do të jetë në administrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe do të ketë në përbërje të saj anëtarë të përzgjedhur nga organet e tjerat të sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, prokurori, gjykata, Ministrinë e Drejtësisë dhe strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.</p> <p>Kjo strukturë synon modernizimin e sistemit përmes zbatimit të teknologjive të reja, eficiencës e gjenerimit të statistikave në institucionet e qeverisjes së gjyqësorit dhe gjykata nëpërmjet integritit të sistemeve të reja.</p>
5.02.b	Sigurimi i mjedisit të punës (zyrë, pajisje hardware dhe software të TI për qendrën e kontrollit).	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.

5.02.c	Trajnimi fillestar i personelit për sistemet elektronike (hartimi i kurrikulave dhe trajnim) Trajnimi vazhdues i personelit për sistemet elektronike.	(Institucioni për t'u caktuar nga KM)	15,000		E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
Aktivitet 5.03	Vendosja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatave (ICMIS), në efikasitet të plotë.					
5.03.a	Specifikimi dhe projektimi funksional.	(KLGJ) AKSHI			E parealizuar	<p>AKSHI: Me VKM-në Nr. 36 datë 24.01.2018 "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 673 datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", është miratuar se:</p> <p>"Sistemi/ infrastruktura" që i bashkëlidhet Vendimit Nr. 673 datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, emërtesat "Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS)" dhe "Sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjyqësorit (ICMIS) në gjykatat administrative" hiqen".</p> <p>Sa më sipër, në zbatim edhe të VKM-së Nr. 36 datë 24.01.2018 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk është autoriteti administrues i sistemit ICMIS, por bazuar në ligjin Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 277, pika 5:</p> <p>"Jo më vonë se 1 muaj nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sistemet aktuale të teknologjisë së informacionit, përfshirë edhe kontratat në fuqi për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e këtyre sistemeve, si dhe çdo dokument tjetër teknik ose juridik kalojnë në dorëzim dhe përgjegjësi të Këshillit nga drejtoria përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor bëhet palë në kontratat ekzistuese ex lege", është Këshilli i Lartë Gjyqësor autoritetit të cilit i përket kjo vendimarrje.</p> <p>Gjithashtu, Komisioni i MD i ngritur me Urdhër Nr. 70/3 prot, datë 25/02/2019 është duke vazhduar punën në bashkëpunim dhe me përfaqësuesit e autorizuar nga KLGJ (Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm, Nr. 43/4, datë 04/03/2019) si dhe Urdhrit të Përbashkët protokolluar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 70/2 prot. datë 25/02/2019 dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. 43/3 prot. datë 25/02/2019 për dorëzimin e Sistemit ICMIS:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore ICMIS (7 Gjykatat Administrative); - Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) 31 gjykatat, Kontratë prokurimi: Nr.1766/14, datë 5.11.2015 me objekt: "Mirëmbajtje dhe zhvillimi i sistemit ICMIS" (31 gjykatat). <p>EURALIUS: Me ngritjen e KLGJ-së, kjo e fundit së bashku me Euralius janë dakortësuar që Euralius të asistojë në konceptimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve në gjykata (ICMIS i Ri). EURALIUS ka filluar të hartojë specifikimet teknike dhe dizajnimin e sistemit.</p>
5.03.b	Prokurimi i ICMIS dhe instalimi.	(KLGJ) AKSHI	1,250,000		E parealizuar	Në varësi të pikës 5.03.a.
5.03.d	Migrimi i të dhënave nga sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve të ICMIS.	(KLGJ) AKSHI	20,000		E parealizuar	Në varësi të pikës 5.03.a dhe 5.03.b.

5.03.f	Arrija e marrëveshjes së mirëmbajtjes për pajisjet e ICMIS (20% e vlerës së software).	(KLGJ) AKSHI			E porealizuar	Në varësi të pikës 5.03.a, 5.03.b dhe 5.03.d.
Aktivitet 5.04	Rritja e funksionalitetit të sistemit të menaxhimit të çështjeve të shërbimit të prokurorisë (CAMS) dhe përshtatja e tij me ndryshimet organizative të institucionit.					
5.04.a	Kryerja e përmirësimeve në sistemin CAMS.	PP	100,000		Në proces	<p>Gjatë vitit 2019 është bërë e mundur ndërlidhja me sistemin e Policisë së Shtetit dhe është në ambientin e testit.</p> <p>Gjatë testeve me modulën e Apeleve u hasën problematika të cilat janë duke u riparuar nga Kompania implementuese.</p> <p>Gjithashtu, vlen të përmendet se moduli i statistikave vazhdon të mbetet në testim, kjo për shkak edhe të ndryshimeve dhe riparimeve të herëpashershme që kompania në bashkëpunim me drejtorinë e IT kryen në sistem.</p> <p>Nga analiza përfundimtare e këtij sistemi nga ana e Drejtorisë IT në Prokurorinë e Përgjithshme, në raport me kërkesat e Kontratës, disa nga pikat e kësaj kontrate janë ende të papërbushura dhe aktualisht kompania është duke punuar për finalizimin e tyre. Gjithashtu, kompania po riparon në bashkëpunim me departamentin e IT-së së prokurorisë defekte të ndryshme që lindin si pasojë e implementimeve që bëhen në sistemin CAMS.</p> <p>Projekti është financim i BE dhe përmirësimet janë kryer në realizim të kësaj kontrate.</p>
5.04.b	Trajnimi i stafit.	PP	10,000		Në proces	Pas testimit të të gjitha funksionaliteteve nga ana e grupit të punës do të kryhet njëtrajnim për stafin e IT-së mbi sistemin CAMS i programuar rreth 40 orë trajnim. Më pas stafi i IT-se do të trajnojë përdoruesit fundorë që janë Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në të gjitha prokuroritë.
Aktivitet 5.05	Rritja e efikasitetit të procesimit të rasteve të Ndhmës Juridike Reciproke (NJR).					
5.05.a+b	Krijimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve për procesimin e çështjeve MLA me MeD (në vazhdim)/ Përfshirja e Prokurorisë së Përgjithshme në sistemin e mësipërm të menaxhimit të çështjeve. Costo përfshin 80,000 euro të financuara nga projekti LURIS	MD, PP	50,000		E porealizuar	Për periudhën janar – mars 2019 nuk ka zhvillime.
5.05.c	Rritja e stafit me 3-5 të punësuar në MD.	MD	36,000		E porealizuar	Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b.
5.05.d	Punësimi i stafit shtesë në PP.	PP	36,000		E porealizuar	Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b.
5.05.e	Sigurimi i pajisjeve (skanera, printera, dhe fotokopje) në MD dhe PP.	MD, PP			E porealizuar	Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b.
5.05.e re	Përmirësimi i përvitshëm.	MD, PP	16,000		E porealizuar	Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b.

Aktivitet 5.07	Përmirësimi i informacionit statistikor të dhënë nga sistemet e menaxhimit të çështjeve të gjykatave (krijimi i një shërbimi të integruar statistikor si një zgjidhje e përkohshme deri sa ICMIS të bëhet funksional.).					
5.07.a	Projektimi i nivelit të lartë dhe prova e konceptit.	(KLGJ) AKSHI			E perealizuar	AKSHI: Lutem referojuni nën-aktivitetit 5.03.a më sipër. EURALIUS: Euralius ka filluar dizenjimin lidhur me përmirësimin e informacionit statistikor të dhënë nga sistemet e menaxhimit të çështjeve të gjykatave.
5.07.b	Projektimi, zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të prodhimit	(KLGJ) AKSHI			E perealizuar	Në varësi të nën-aktivitetit 5.07.a.
Aktivitet 5.08	Krijimi i sistemit elektronik të publikimit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare.					
5.08.a	Përgatitja e një sistemi të integruar për publikimin e ligjeve të konsoliduara dhe akteve nënligjore të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave.	(QBZ) AKSHI	0		E realizuar	QBZ: Ndërtimi i sistemit të integruar për publikimin e ligjeve të konsoliduara dhe akteve nënligjore të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave (Arkiva Elektronike e QBZ) ka përfunduar në datë 29.03.2019. AKSHI: Projekti ka arritur objektivin e përgjithshëm: krijimin e Sistemit të Arkivës Elektronike të Akteve, që shërben për regjistrimin, editimin, publikimin, përditësimin, ruajtjen, administrimin dhe aksesimin e të gjithë akteve të botueshme në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, politikat kombëtare dhe praktikave më të mira në botë në këtë drejtim. Kërkim të shpejtë dhe efektiv të akteve ligjore përmes kërkimit të avancuar dhe në përmbajtje të tekstit. Paraqitje e akteve dhe ndryshimeve të tyre në kohë, lidhjes mes tyre, nga përdoruesit e brendshëm dhe ata publike në çdo formë të publikimit nga QBZ. Automatizim dhe kontroll të proceseve, krijimi, kontrolli dhe aprovimi i dokumentave. Ruajtje, arkivim dhe ripërdorim të informacionit në trajtë dixhitale.
5.08.b	Popullimi i sistemit me aktet ekzistuese.	(QBZ) AKSHI			E realizuar	QBZ: Me dorëzimin e sistemit, si pjesë integrale e sistemit, ka përfunduar popullimi i akteve ekzistuese për periudhën 2000 – 2018. Popullimi me aktet në vijueshmëri në faqen web të QBZ është proces i përditshëm i botimit në Fletoren Zyrtare. Menjëherë pas botimit të Fletores Zyrtare bëhet publikimi në kohë reale i akteve të ndara në faqen web të QBZ-së. Gjithashtu, bëhet publikimi i akteve të përditësuara dhe i përmbledhëseve të legjislacionit. AKSHI: Sistemi i ri informativ i akteve ligjore përmbush këto objektiva kryesore: Publikim elektronik të legjislacionit në format që detyron legjislacioni shqiptar për publikimin. Aksesim të shpejtë të statusit aktual të legjislacionit shqiptar, siguri të legjislacionit shqiptar të konsoliduara. Gjenerim të standardizuar dhe efektiv të informacionit në të gjithë fazat e tij.
5.08.c	Publikimi i vendimeve gjyqësore.	(QBZ) AKSHI			E realizuar	QBZ: Në fletoren zyrtare dhe në Arkivën Elektronike botohen Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. AKSHI: Janë publikuar të gjitha vendimet gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Vendime të ardhura për botim në QBZ.
Aktivitet 5.09	Rritja e efikasitetit të funksionimit të përmbauesve në përputhje me standardet moderne europiane.					

5.09.b	Përmirësimi i ndërlidhjeve ndërmjet ALBIS dhe sistemeve të tjera elektronike të gjyqësorit.	(MD, Përbarimi) AKSHI	0		Në proces	Në zbatim të kontratës Nr.7260/13, datë 09.02.2017 Sistemi ALBIS, për periudhën janar- mars 2019 vazhdon të jetë në periudhën e mirëmbajtjes nga operatori ekonomik i kontraktuar. Gjithashtu, ka filluar të përdoret dhe në sistem janë hedhur dosje përbarimore nga zyrat e përbarimit shtetërore. Sa i përket ndërlidhjeve me sistemet e tjera të gjyqësorit kjo nuk është e realizuar, pasi nuk është e parashikuar as në termat e referencës. Nga ana e AKSHI-t i është propozuar MD-së të filloj procesin e regjistrimit të ALBIS si bazë të dhënash shtetërore bazuar në ligjin Nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore", proces ky që është në hapat e para të tij.
Aktivitet 5.11	Përmirësimi i funksionimit të sistemit të vuajtjes së dënimit duke siguruar sistemet e nevojshme të teknologjisë deri brenda vitit 2020.					
5.11.c	Projektimi i bazave të të dhënave (sistemi i Cards) ndërmjet IEVPve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.	(MD) DPB			E përealizuar	Ky aktivitet duhet rishikuar pasi DPB ka në përdorim sistemin e kartelave të denuarve (MISP). Sistemi CARDS nuk disponohet nga DPB.
Aktivitet 5.12	Përmirësimi i kushteve të punës sipas standardeve moderne të PP dhe zyrave të prokurorive në qytete.					
5.12.0	Realizimi i vlerësimit të nevojave (me prioritetizim) dhe i studimit të fizibilitet si dhe kostim për rindërtim/ndërtim të godinave të reja.	PP			Në proces	Në vitin 2018, në kuadër të rishikimit të paketës kombëtare të projekteve strategjike është analizuar nevoja për ndërtimin e tre godinave të reja në prokuroritë Durrës, Tiranë e Vlorë.
Aktivitet 5.13	Përmirësimi i kushteve të punës sipas standardeve moderne të gjykatave (nëpërmjet ndërtimit të godinave të reja për gjykatat më poshtë):					
5.13.0	Realizimi i vlerësimit të nevojave (me prioritetizim) dhe i studimit të fizibilitet si dhe kostim për rindërtim/ndërtim të godinave të reja.	(KLGJ) ZABGJ			E përealizuar	Përmbushja e këtij aktiviteti kushtëzohet nga ndryshimet e pritshme në riorganizimin e gjykatave. Me miratimin e hartës së re gjyqësore do të vlerësohen nevojat dhe do të kryhen studimet përkatëse për ndërtim të godinave të reja dhe/ose rikonstruksion të plotë godinave ekzistuese të gjykatave.
5.13.e re	Përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore në gjykata.	(KLGJ) ZABGJ	2,000,000		E përealizuar	Investimet në infrastrukturën ndërtimore janë të lidhura me miratimin e hartës së re gjyqësore, që është në proces. Me përfundimin e këtij procesi do të planifikohen investimet për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore.
Aktivitet 5.14	Ngritja e efektivitetit të hetimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rritja e efektivitetit dhe decentralizimit të përgjimeve					
5.14.c	Hartimi i specifikimeve teknike për pajisjen e përgjimit Blerja e pajisjeve të nevojshme (një njësi qendrore për SPAK) Mirëmbajtja e pajisjes.	PP	100,000		E realizuar për PP	Raportimi për vitin 2017 jep detaje për kontratën e blerjes dhe koston. Ndërkohë në muajin qershor 2018, në kuadër të rishikimit të paketës kombëtare të projekteve strategjike PP ka identifikuar nevojën për mbështetje për decentralizimin e përgjimeve.
5.14.d	Ndërtimi i kapaciteteve.	PP			Në proces	Përsa i përket ndërtimit të kapaciteteve nga PP, ky nën-aktivitet ka qenë i realizuar për vitin 2018, për më tepër informacion referojuni Raportit Vjetor të Monitorimit për vitin 2018. Gjithashtu, duke qenë se kjo është masë në vijimësi, gjatë vitit 2019 priten të realizohen trajnime të tjera, në këtë kuadër.

Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Aktiviteti	Përshkrimi i Aktivitetit	Institucioni përgjegjës	Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro)	Buxheti i alokuar për çdo aktivitet	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-mars 2019 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-mars 2019
Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.						
Aktivitet 6.01	Rritja e mundësisë për punësimin e të burgosurve dhe ofrimin e programeve të edukimit / programeve të aftësive jetësore sipas standardeve evropiane të praktikave më të mira.					
6.01.d	Ofrimi i kurseve në aftësitë bazë dhe ato teknike.	MD, DPB	10,000	1.162.500 lekë	E realizuar	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Në zbatim të kësaj marrëveshje, procesi i formimit profesional është zhvilluar mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike dhe bazën materiale që disponojnë institucionet, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga DRFP. Si rezultat, për periudhën Janar-Mars 2019, kurset profesionale janë ofruar në 10 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 454 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektrikist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, trobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.
6.01.e	Ofrimi i programeve edukuese kundër recidivizmit.	MD, DPB	10,000	1.162.500 lekë	E realizuar	Janë hartuar dhe vënë në zbatim programe edukuese për të burgosurit në prag lirimi. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste. Këto kurse janë ndjekur nga 25 të burgosur.
6.01.f	Ofrimi i programeve edukuese kundër përdorimit të drogave.	MD, DPB	20,000	1.162.500 lekë	E realizuar	Rehabilitimi i personave të burgosur, ish përdorues të lëndëve narkotike është një objektivi i veçantë i sektorit të edukimit. Në këtë kuadër ofrohen programe për personat e burgosur të cilët kanë qenë përdorues të lëndëve narkotike në jetën e lirë. Këto programe janë frekuentuar mesatarisht në muaj nga 107 të burgosur.
6.01.g	Ofrimi i programeve të tjera edukative.	MD, DPB	20,000	1.162.500 lekë	E realizuar	Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën gjatë 1 muaji aktivitetet e tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve është 2860. Gjatë periudhës janar - mars 2019 në IEVP janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 140 tema sociale në muaj dhe 26 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 419 aktivitetet ri-integruese.
Aktivitet 6.02	Reduktimi i mbipopullimit në burgje dhe paraburgim sipas standardeve evropiane.					
6.02.e re	Blerja e 30 makinave ambulancë.	MD, DPB		0	Në proces	Për vitin 2019 janë planifikuar që të blihen 4 automjete më fonde të buxhetit të shtetit. Kosto e parashikuar në buxhet është 36.000.000 lekë. Procedurat janë në proces.
Aktivitet 6.03	Garantimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të ndaluarve me probleme të shëndetit mendor.					
6.03.b	Ndërtimi i një ndërtese të re të përshtatshme për trajtimin e të ndaluarve me probleme të shëndetit mendor.	MD	4,016,000		Në proces	Është kryer një zgjidhje afatshkurtër për akomodimin e personave me masë mjekësore "mjekim i detyruar" në dy godina në IEVP Lezhë, godina 4 dhe 5. Rikonstruksioni i godinave dhe përshtatja si një institucion i veçantë mjekësor është në proces dhe është planifikuar të mbyllet brenda vitit 2019. Kosto e parashikuar e investimit për vitin 2019 është 27.247.000 lekë.
6.03.c	Promovimi i bashkëpunimit ndër-institucional për trajtimin e kësaj kategorie.	MD		1.245.600 lekë	Në proces	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë duke adresuar masa konkrete për përshtatjen e godinave të IEVP Lezhë në ambiente spitalore për akomodimin dhe trajtimin e kësaj kategorie, deri në ndërtimin e Spitalit Psikiatrik Ligjor për shtetasit me masë mjekësore. Takimi i fundit u zhvillua më datë 26.03.2019 në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë, me përfaqësues

						të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në kuadër të hartimit të masave tranzitore për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të këtyre personave. Gjithashtu, u vendos për ngritjen e komisionit të përbashkët me ekspertë të fushës për evidentimin e nevojave për fonde shtesë për përbushjen e rekomandimeve të lëna nga ekspertët e Komitetit Evropian të Parandalimit të Torturës për këta shtetas.
6.03.d	Bashkëpunimi me OJF që ndajnë praktikat e mira dhe të suksesshme për trajtimin e kësaj kategorie në përputhje me standardet evropiane.	MD, DPB		1.245.600 lekë	E realizuar	Gjatë periudhës janar-mars 2019 janë nënshkruar 8 marrëveshje bashkëpunimi me OJF, ku qëllim kryesor i bashkëpunimit mbetet përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave me liri të kufizuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.
Aktivitet 6.05	Përmirësimi i nivelit të burimeve njerëzore të alokuara për rehabilitimin e të burgosurve.					
6.05.a	Ndryshimi i skemës së pagave për stafin e ri mjekësor.	MD			E parealizuar	Duke marrë në konsideratë kërkesat e parashtruara të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për rritjen e pagave të mjekëve të cilët shërbejnë në sistemin e burgjeve, me shkresën nr. 1825/1, datë 06.12.2018, Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka kthyer përgjigje që kërkesat shtesë për vitin 2019 në lidhje me këtë kërkesë nuk mund të miratohen. Gjithashtu, ka udhëzuar që kërkesat për rritjen e pagave të mjekëve të përfshihen në parashikimet e PBA 2020-2022. Si rrjedhojë, është kryer parashikimi për rritjen e pagave të mjekëve, bashkë me koston financiare. Me shkresën nr. 2058/1 datë 02.04.2019 Ministria e Drejtësisë, nisur nga ky fakt, ka udhëzuar gjithashtu, që kërkesa për rritjen e pagave të mjekëve të përfshihet në kërkesat buxhetore të DPB-së për vitin 2020-2022.
6.05.c	Programet e trajnimit për stafin e ri civil.	DPB		49.349.000 lekë	E realizuar	Janë hartuar dhe miratuar programet e trajnimit për stafin e ri civil. Programet janë pasuruar me module praktike për menaxhimin e personave me liri të kufizuar dhe drejtimin human të burgjeve. Për periudhën janar - mars 2019 janë trajnuar afërsisht 40 staf civil multidisiplinar.
Aktivitet 6.06	Forcimi dhe përmirësimi i shërbimit të provës sipas standardeve moderne evropiane.					
6.06.a	Rritja e nr të të punësuarve dhe llojshmërisë së aftësive në shërbimin e provës.	MD, Shërbimi i Provës			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019.
6.06.b	Zgjerimi i përdorimit të sistemit të monitorimit.	MD, Shërbimi i Provës			E parealizuar	Nuk ka zhvillime për periudhën janar-mars 2019
6.06.c	Ndërtimi i zyrave të shërbimit të provës në Tiranë.	MD, Shërbimi i Provës			E parealizuar	Është lidhur kontrata për hartimin e projektit, i miratuar nga AZHT me nr.03/7 dt.03.04.2017. Është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr.01/7 dt.13.06.2017. Është përpiluar projekt/vendimi nr.13 dt.02.02.2018 nga KRRT. Aktualisht në territorin pronë e Shërbimit të Provës, Bashkia Tiranë ka ndërtuar rrugë për kalim makinash dhe këmbësorësh, gjë e cila e bën të pamundur realizimin e këtij projekti.
Aktivitet 6.07	Përmirësim i sigurisë fizike në burgje si dhe parandalim dhe mbikëqyrje e komunikimit nga të dënuarit. Gjithashtu, përcaktimi i një niveli kualifikimi të pranueshëm për drejtorët e burgjeve.					
6.07.b	Prokurimi i punimeve, të mirave dhe shërbimeve për përmirësimin e sigurisë fizike të të dënuarve.	DPB			Në proces	Për përmirësimin e kushteve të trajtimit të personave me liri të kufizuar janë planifikuar këto investime: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë në disa IEVP. ▪ Sistemimi i ujerave të zeza në IEVP Korçë. ▪ Përmirësim i kushteve të jetesës në IEVP Sarandë. ▪ Rikonstruksion i bllokut të dusheve në godinën

						nr. 3 në I EVP Lezhë. Kostot e parashikuara të investimeve për vitin 2019 janë: - Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë në disa I EVP, në vlerën prej 10.000.000 lekë. - Sistemimi i ujerave të zeza në I EVP Korçë, në vlerën prej 5.000.000 lekë. - Përmirësim i kushteve të jetesës në I EVP Sarandë në vlerën prej 4.642.000 lekë. - Rikonstruktion i bllokut të dusheve në godinën nr. 3 në I EVP Lezhë, në vlerën prej 4.000.000 lekë.
